

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“RecycAL” SHPK

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
“RecycAL” SHPK

- **LULZIM BAUMANN**, atësia Gezim, amësia Shqipe, shtetas Shqiptar, lindur në Prezë, Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë rruga “Elezeve” Nd. 32; H. 1; Prezë; Ahmetaq; 1039; Vorë; lindur më datë 25/08/1993, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i dokumentit të identifikimit, Leternjoftim ID nr. 033320196 dhe nr. personal J30825048A, me vullnet të lirë e me zotësi të plotë për të vepruar

Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit Shqiptar, vendosen të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “RecycAL” SHPK. mbi bazën e këtyre principeve:

NENI 1
FORMA DHE EMRI

- 1.1 Shoqëria ka formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakut në kapitalin themeltar. Emri i shoqërisë “RecycAL” SHPK.

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1 Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin Shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërisë si dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë



NENI 3 SELIA

3.1 Selia e shoqërisë është në adresën rruga “Elezeve”; Nd. 32; H. 1; ; Prezë; Ahmetaq; 1039; Vorë.

Në adresën e mësipërme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim të asamblesë së përgjithshme, mund të hapen degë, filiale, agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në të cilat e ushtron veprimtarinë shoqëria.

NENI 4 KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË

4.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat të papërcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likuidimi me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas rasteve të parashikuara në ligj

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISË

5.1 Shoqëria “RecycAL” Sh.p.k. është e organizuar në fornën e një shoqërie e cila ka si objektiv:

- Grumbullimin edhe magazinimi i mbetjeve i mbetjeve jo të rrezikshme si letrës, plastiks, metaleve, inerte edhe mbetjeve që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, selektimin e tyre, shypjen/presimin dhe shitje e mëtejshme.
- Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.
- Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE).
- Magazinim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.
- Kompostimi i mbetjeve bio.
- Edukim, konsulence, trajnime, projekte në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, specifikisht menaxhimit të mbeturinave dhe ekonomisë qarkore.



- Pjesëmarrje në tendera publike, private, kombetare edhe nderkombetare per aktivitete të lidhura me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

5.2 Shoqëria “RecycAL” shpk ushtron veprimtarinë e saj duke patur në fokus të veprimtarisë së saj mbrojtjen e mjedisit dhe realizimin e fitimit për të bërë shoqërinë financiarisht të qëndrueshme edhe të pavarur, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni Shqiptar. Shoqëria deri në 25% të fitimit të saj vjetor do ta shpërndajë dhe dhurojë për projekte të tjera në mbrojtje të mjedisit, me fokus edukimin mjedisor.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 LEKË (dhjetë mijë Lekë), i ndarë në 1 pjesë. Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

1. LULZIM BAUMANN	100,00%	10.000,00 LEKË
--------------------------	----------------	-----------------------

6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është shlyer tërësisht në para dhe është depozituar në një llogari të hapur në emër të shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.

NENI 7 AKTET E SHOQERISE

7.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij akt-themelimi edhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku i shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8 ORGANET DREJTUESE

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme dhe Administratori.

8.2 Shoqëria mund të emërojë më shumë se një Administrator. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar Administratorët e shoqërisë “RecycAL” Sh.p.k ky term nënkupton të gjithë Administratorët e saj sado qofshin këta në numër. Administratori shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.



- 8.3 Përveç organeve të parashikuara më sipër Asambleja e Përgjithshme mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohet kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.
- 8.4 Administratori i shoqërisë **Z. Lulzim Baumann** është emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare. Në rast se në vijim do të emërohen administratorë të tjerë ata mund t'i ushtrojnë kompetencat e tyre bashkarisht ose veç e veç.

NENI 15 DISPOZITA TË FUNDIT

- 15.1 Çdo mosmarrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.
- 15.2 Ky Akt-themelimi është hartuar në 2 (dy) ekzemplarë në gjuhën Shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njejtë ligjore.

Tiranë, 07/11/2022

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË

“RecycAL” SH.P.K

LULZIM BAUMANN

Lulzim Baumann

